



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:077714
Datë: 27.07.2023
Numri i dokumentit: 04529123

A.nr. 917/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Anita Nikci-Morina në konfliktin administrativ të paditësit BIRN/RTK me a dresë Rr. "Afrim Zhitia" Nr. 7 Prishtinë, përfaqësuar nga Jeta Xhara dhe Labinot Leposhtica, kundër të paditurës Komisioni i Pavarur për Media i Republikës së Kosovës me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Herolinde Zagregja Goci, për shkak të anulimit të vendimit, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të palëve ndërgjygjëse me dt. 07.07.2023 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **Aprovohet** kërkesëpadia e paditësit, BIRN/RTK si e bazuar dhe **Anulohet** vendimi i të paditurës KPM- Bordi i Ankesave nr.ref: 12/2021 dhe 2103/363/BA/YF dt. 22.03.2021
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e procedurës administrative.

A r s y e t i m

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit në seancën e shqyrtimit gjyqësor deklaroi, se me vendimin e të paditurës, Komisioni i Pavarur për Media - Bordi i Ankesave, nr.ref: 12/2021 dhe 2103/363/BA/YF dt. 22.03.2021 është aprovuar pjesërisht si e bazuar ankesa e RTK-së këtu e tutje paditës datës 08.03.2021, kundër Vendimit të Komisionit Ref: 2102/79/KPM të datës 28.01.2021 sa i përket shkeljes së nenit 5 paragrafi 5 dhe nenit 7 paragrafit 6 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 ndërsa pjesa tjetër e Vendimit të KPM-së lidhur me përgjegjësinë e BIRN për përdorimin e gjuhës denigruese dhe të pasaktë është lënë në fuqi.

Paditësja pretendon se vendimi i Bordi të Ankesave të KPM-së nuk mbështetet në gjendjen faktike, se nuk ka adresuar provat e ofruara në procedurë dhe se vendimi i kontestuar është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative. Për më tepër, paditësja pretendon se përdorimi i shprehjeve sarkastike dhe ironike është i lejuar në kuptim të standardeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në kuadër të nenit 10 (Liria e Shprehjes) në kuadër të të cilave theksohet se liria e shprehjes nuk kufizohet vetëm në publikimin e informacioneve të favorshme apo promovuese por edhe në informacione të cilat janë ofenduese dhe që shokojnë publikun (duke iu referuar rastit *Handyside kundër Britanisë së Madhe*).

Përfaqësuesja e të paditurës në seancën e shqyrtimit gjyqësore deklaroi se qëndrojmë në tërësi pranë përgjigjes në padi duke deklaruar se sa i përket asaj që tha drejtoresha e BIRN-it, asgjë nga ato nuk qëndrojnë, për arsye se nuk kanë të bëjnë me rastin në fjalë, ky rast nuk te beje çështje personale apo për dyshime për korrupsion brenda institucionit, KPM-ja asnjëherë nuk i ka kontestuar të gjetat e hulumtimit të raportit, ndërsa sa i përket pa saktësisë që ka të bëjë me dy raste ku KPM-ja ka gjet se është në shkelje e nenit 6.1 të Kodit të etikës, i cili përcakton se lajmet duhet të jenë të sakta dhe të pa anshme ndërkohë kronika ose emisioni nga pala paditëse ndërlihet me aktivitetet biznes ore të produkteve si jastëk, dyshek, kafe, biznese këto të cilat nuk janë në pronësi të palës ankuese si dhe në rastin tjetër të Telekomit të Kosovës në emision është konstatuar se pala ankuese ka dëmtuar Valën e Kosovës, duke treguar se Kuvendi ka kërkuar hetim lidhur me rastin nga Prokuroria e Shtetit, për derisa nuk ka vendim final pas këtij procesi nga ana e organeve kompetente. Përfaqësuesja me tej shton në deklaratën e dhënë pranë gjykatës sa i përket përfaqësuesit ligjor të paditësit i cili deklaroj se vendimi është në kundërshtim me ligjin e procedurës administrative, pala e paditur e kundërshton këtë pretendim me arsyetimin se vendimi i përmbanë të gjitha elementet e kërkuara duke përfshirë pjesën hyrëse dispozitivin, arsyetimin dhe pjesën përmblyëse.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor – publik të datës 07.07.2023 ka administruar provat relevante dhe atë është administruar: Kopja e letër njoftimit të paditësit Labinot Leposhtica, ankesa e dt.08.03.2021, njoftimi nga kabineti i Kryetares së Kuvendit, datë 08.05.2020, lidhur me kërkesën lidhur për hetimin e rastit të adresuar, prova aktvendimi i Gjykatës së Apelit dt.17.06.2020, njoftimi nga zyra e Kryeprokurorit të shtetit, përgjigja na Autoriteti i konkurrencës dt.06.05.2020, vendimi i KNSH dt.24.11.2020, përgjigja e Agjencisë kundër korrupsionit dt.23.04.2020, emisioni monopol “me dritë të diellit ZRRE dhe Devolli, intervistë me Aren Kllokoqi, prova CD dhe linku i emisionit të sipër përmendur, vendimi i ZRRE-së dt.19.05.2016, vendimi i ZRRES 27.11.2019, certifikata e regjistrimit të bizneseve e Birra Peja, certifikata e regj. Biznesit BRAEN L.L.C, certifikata e regjistrimit të bizneseve në Maltë, ABRAZEN, dokumenti i ARBK-së i dorëzuar në ZRRE, në lidhje me ABRAZEN, Devolli Group, certifikata e regjistrimit të biznesit në Kosovë, Frigo dhe FooK Kosova, certifikata e regjistrimit në Maltë Frigo, FOO solar, certifikata e regjistrimit të biznesit Arsi C.O Kosovë, certifikata e regjistrimit të biznesit në Maltë, ALSI SO LTD, certifikata e regjistrimit të biznesit energji Devoll Group, certifikata e regjistrimit të biznesit në altë EDG LTD, certifikata e regjistrimit të biznesit në Kosovë, Bolding konstrukshion L.L.C, certifikata e regjistrimit solar Pover holding, certifikata e biznesit Devoll Group, dokumenti i ARBK-së, i dorëzuar në ARBK, pyetja dërguar ankuesit i rikujtimi dërguar ankuesi ddt.22.04.2020, publikimi i reagimit dhe përgjigja e dt.25.05.2020, rezoluta e KK, dt.07.07.2018, vendimi i KPM dt.10.06.2020, vendimi i KPM 03.11.2020, njoftimi i AGK, për përmbajtjen e ceremonisë për ndarjen e çmimit të dt.20.11.2020, komunikata e komisionit të ndihmës shtetërore dt.26.11.2020, dhe komunikata Sekretariatit i Komunitetit të energjisë me seli në Vjenë dt.26.11.2020, dhe përgjigja e Autoritetit të Konkurrencës për Kalxo.com dt.24.11.2020.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, në përputhje me nenin 44 të LKA-së, dhe pas vlerësimit të thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë çështje administrative, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e **bazuar**.

Gjykata vëren se me KPM më datë 3 nëntor 2020 nxjerrë vendimin nr.REF:2011/836/KPM me të cilin i ka shqiptuar 'vërejtje' palës paditëse (RTK).

Paditësit përmes RTK-së si Palë Përgjegjëse më datë 7 dhjetor 2020 kanë parashtruar ankesë në Bordin e Ankesave të KPM-së si organ i shkallës së dytë, i cili më datë 13 janar 2021 me vendimin me nr. REF. 2101/047 e aprovon ankesën e Paditësve dhe anulon vendimin e Komisionit me nr. REF:2011/836/KPM.

Duke ri-vendosur çështjen, Komisioni i KPM-së për herë të dytë me vendimin. Ref 2102/79/KPM të datës 3 shkurt 2021 me të cilin i shqipton sërish 'vërejtje' Paditësve.

Duke vepruar në bazë të ankesës së paditësit (8 mars 2021), Bordi për Ankesa i KPM-së nxjerr vendimin me numër 12/2021 dhe nr. REF 2103/363 të datës 22 mars 2021 me të cilin aprovon pjesërisht ankesën e paditësve. Në vendimin e organit të paditur është thekuar se është aprovuar pjesa e Ankesës së Paditësve dhe është konstatuar që emisioni “Monopoli me dritë të diellit, ZRrE dhe Devolli”, nuk ka nxitur Urrejtje dhe nuk ka pasur kritikizëm të padrejtë, por ka konstatuar se ky emision ka përdorur “gjuhë denigruese” dhe është shoqëruar me “pasaktësi” sipas nenit 5 paragrafi 2 dhe nenit 6 para. 1 të Kodit të Etikës së KKPM-së.

Duke analizuar nëse vendimi i kontestuar me padi është i ligjshëm, Gjykata i referohet Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila në kuadër të neni 40 [Liria e Shprehjes] ka përcaktuar se 1. Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush. 2. Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.

Neni 42 [Liria e Medie] 1. Garantohe liria dhe pluralizmi i medie. 2. Censura është e ndaluar. Askush nuk mund të pengojë shpërndarjen e informacionit ose të ideve nëpërmjet medie, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare. 3. Çdokush ka të drejtë të korigjojë informacionin e pavërtetë, jo të plotë ose të pasaktë të publikuar, nëse cenon të drejtat ose interesat e saj/tij, në pajtim me ligjin.

Gjykata i referohet edhe neni 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] sipas të cilit “të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”. Duke analizuar vendimin e kontestuar me padi, Gjykata konsideron se nuk rezulton që organi i paditur të ketë marr në konsideratë interpretimet dhe

vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut me rastin e vendosjes së çështjes administrative lidhur me pretendimet ankimore të paditësit.

Kurse sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që gjen zbatim të drejtpërdrejtë në sistemin juridik të Rep. së Kosovës parashihet që “1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t’u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me liçencë. 2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”

Në mungesë të interpretimit të organi të paditur dhe pa ofruar arsyeje mjaft bindëse në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se interpretimi juridik i dhënë në vendimin e kontestuar me padi të jetë i ngushtë në fushëveprim. Për dallim nga përfundimi i organit të paditur, Gjykata konsideron se kualifikimet ndaj shkrimit të RTK-së të kundërshtuara në KPM si organ i paditur nuk duket se përbëjnë fyerje ngaqë gjuha e përdorur është sarkastike.

Duke vepruar në pajtim me nenin 53 të Kushtetutës që e bën të detyrueshme zbatimin e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, është vet GJEDNJ e cila në një numër të rasteve ka konsideruar se promovimi i debatit të lirë është një tipar i rëndësishëm i një shoqërie demokratike duke konsideruar se kërkohen arsye shumë të forta për të justifikuar kufizimet e fjalës politike. Lejimi i kufizimeve të gjera të fjalës politike në raste individuale do të ndikonte pa dyshim në respektimin e lirisë së shprehjes në përgjithësi në shtetin në fjalë (shih *Brasilier kundër Francës*, nr. 71343/01, § 41, 11 prill 2006).

Siç ka argumentuar edhe GJEDNJ në çështjen *I.E.R. kundër Ukrainës (Aplikacioni 61561/08)* dt. 02.06.2016 “Liria e shprehjes përbën një nga themelet thelbësore të një shoqërie demokratike dhe një nga kushtet bazë për përparimin e saj dhe për vetëpërmbushjen e çdo individit. Në varësi të paragrafit 2 të nenit 10, ai zbatohet jo vetëm për "informacionet" ose "idetë" që pranohen në mënyrë të favorshme ose konsiderohen si jofyese ose si çështje indiferente, por edhe për ato që ofendojnë, tronditin ose shqetësojnë. Të tilla janë kërkesat e pluralizmit dhe tolerancës pa të cilat nuk ka shoqëri demokratike. Siç parashikohet në nenin 10, kjo liri u nënshtrohet përjashtimeve, të cilat, megjithatë, duhet të interpretohen në mënyrë rigorozë dhe nevoja për çdo kufizim duhet të përcaktohet në mënyrë bindëse”.

Prandaj, gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative, organi i paditur nuk ka vepruar konform kërkesave të përcaktuara me nenin 40, 42 dhe 53 të Kushtetutës së Rep. së Kosovës dhe praktikës relevante të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut me rastin shqyrtimit të

Numri i lëndës: 2021:077714
Datë: 27.07.2023
Numri i dokumentit: 04529123

ankesës së palës paditëse kundër vendimit të KPM-së nr. Ref 2102/79/KPM të datës 3 shkurt 2021.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës vendosi konform nenit 64 të LK-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartë cekura, gjykata në kuptim të nenit 43.3, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA HEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr. 917/21 i dt. 07.07.2023



Gjyqtarja
Anita Nikçi Morina

KESHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, ne Gjykatën e Apelit ne Prishtine, përmes kësaj gjykate.